



Pranimi / Dorezuar Received / Delivered		06.04.2023		viti year	
Organ / Pjesa Organ / Jednica Org / Unit	Hi Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKANSACK	3339	2023	1/5		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.323/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Tashi Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi- anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.323/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Veleknicë Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike „ kundër vlerësimit të punës për vitin 2022”, dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. ANULOHET vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 i datës 30.01.2023 për ankuesin
- II. OBLIGOHET Drejtoresha e Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Gjilanit që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, t’i ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim që ankuesit t’i bëhet rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 për periudhën sa ankuesi ka qenë në varësi të saj.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Gjilanit, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në sipërkëtë pikë II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër protokoli 51840 të datës 01.07.2020 në pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Inspektim” në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Gjilanit, më datë 04.02.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1495/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022, nga mbikëqyrësja e

drejtpërdrejtë e fundit gjegjësisht nga Drejtoresha e Drejtorisë së Inspektionit i është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë vlerësimin e rezultateve të punës dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.02.2023 me ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë numër protokollit 1835/2023 në Komunën e Gjilanit. Ndërsa Këshilli me datë 03.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2288/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.03.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1495/2023 të datës 07.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i S.K. i datës 31.01.2023; E-mail nga S.K. për E.H. i datës 01.02.2023; Pliko me numër R2655852 i datës 04.02.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1835/2023 i datës 15.02.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 2288/2023 i datës 03.03.2023; Akt Emërim i S.K. me numër protokollit 51840 i datës 01.07.2020; E-mail nga E.H. për S.K. i datës 22.01.2023; E-mail nga E.H. për S.K. i datës 30.01.2023; E-mail nga E.H. për S.K. i datës 02.02.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor me numër prot.nr.02/016/01-0140-533/22 i datës 08.12.2022; E-mail nga S.K. për E.H. i datës 20.12.2022; E-mail nga A.M. për E.H. i datës 01.01.2023; E-mail nga E.H. për A.M. i datës 23.12.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i sektorit për inspektim" në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Gjilanit; E-mail nga E.H. për S.K. i datës 22.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i S.K. i datës 23.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i S.K. i datës 02.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i S.K. i datës 23.01.2023; E-mail nga F.H. për C.Z. i datës 20.03.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për kategorinë e lartë drejtuese i S.K. i datës 30.01.2023; Vendim me numër VK/2023 i datës 21.03.2023. Emaili i datës 28.03.2023 i zyrtares se personelit se bashku me provat shtese.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të *kthehet në rivlerësim, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës te datës 07.02.2023 ka theksuar që formularin e vlerësimit për periudhën dy mujore konkretisht nga data 08.11.2022 deri me 31.12.2022, e ka pranuar me datën 31.01.2023, ndërsa ankuesi me datë 01.02.2023 përmes emailit zyrtar ka kërkuar nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e tij që të takohet në mënyrë që të diskutojnë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 dhe njëkohësisht ai kërkon që

vlerësimi ti bëhet ne pajtim me legjislacionin ne fuqi konkretisht ne pajtim me nenin 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, mirëpo mbikëqyrësja nuk i kthen përgjigje, andaj ankuesi me date 07.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1495/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 për periudhën dy mujore nga Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e fundit e tij, është bere në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht me nenin 43 dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit me numër Nr.02-016-47017 të datës 29.04.2022, është transferuar përkohësisht nga pozita "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime" në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit në pozitën "Udhëheqësi i Sektorit Financiar" në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, ndërsa sipas Vendimit me numër Nr.02-16-63238 të datës 03.06.2022, ankuesi i cili është transferuar përkohësisht nga pozita "Udhëheqësi i Sektorit Financiar" në kuadër të Drejtorisë së Arsimit transferohet ne pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve" në kuadër të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ne Komunën e Gjilanit. Pas përfundimit te periudhës se transferit ankuesi me date 08.11.2023 kthehet ne pozitën e tij sipas Aktit të emërimit respektivisht ne pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime" në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi gjate vitit 2022 ka pasur me shume se dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë konkretisht nga data 03.06.2022 deri me datë 05.11.2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij ka qenë z. [Blank], Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, ndërsa nga data 8 nëntor 2022 deri me datë 31 dhjetor 2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij ka qenë [Blank] Drejtore e Drejtorisë së Inspektionit. Tutje Kolegji ka konstatuar se ankuesi nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë z. [Blank] Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, me datë 23.01.2023 ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve te punës për periudhën nga data 06.06.2022 deri me datë 05.11.2022 me notë të përgjithshme 4.82, ndërsa me datë 30.01.2023 ankuesi ka pranuar nga Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit formularin e vlerësimit të rezultateve të punës me notë të përgjithshme 3.2, pa e përcaktuar në formular periudhën e vlerësimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 43 paragrafi 1, 2 dhe 5 i cili përcakton se: „Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit ndërsa paragrafi 5 i këtij neni përcakton se : „5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse” ndërlidhur me këtë çështja e ndërrimit të mbikëqyrësit është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, përkatësisht nenin 5 paragrafin 2 ku përcaktohet se: “2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson

nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunëseve civil duhet tu behet vlerësimi i rezultateve të punës për *periudhën prej një (1) viti pa* marre parasysh ndërrimin e mbikëqyrësve andaj ne rastin konkret Kolegji ne baze te dëshmimeve te ofruara ka konstatuar se ankuesit i mungon vlerësimi i rezultateve te punës për periudhën nga data 1 janar 2022 deri me date 29.04.2022, nuk është përfshirë vlerësimi për këtë periudhë nga te dy mbikëqyrësit e ndryshëm konkretisht periudha ku ankuesi ka ushtruar pozitën e *“Udhëheqësit te Sektorit për Inspektime”* e ku mbikëqyrës te drejtpërdrejtë e ka pasur Drejtoreshen e Drejtorisë së Inspektionit, andaj Kolegji konstaton se kjo e fundit është e obliguar qe ankuesit ti beje vlerësimin e rezultateve te punës dhe te përfshijë në vlerësimin përfundimtar edhe këtë periudhë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që vlerësimi i rezultateve te punës për vitin 2022 nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit, për ankuesin Sali Kqiku është bërë në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, ku përcaktohet se: *“4. Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit.”*. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit, pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësja e tij e drejtpërdrejtë, dhe pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit në fund të periudhës së vlerësimit ka ftuar ankuesin për të diskutuar për realizimin e objektivave dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: *“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektivave”*.

Po ashtu ankuesi ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit nga I-III, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakt, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankuesit për vitin 2022, ka konstatuar se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit konkretisht Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit, ankuesin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 3.2 mirëpo tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesi me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankuesit gabimisht ka përdorur formularin e vlerësimit të rezultateve te punës për vitin 2022 për ankuesin konkretisht vlerësimin e rezultateve te punës për ankuesin e ka bere sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve te Punës për Kategorinë e Larte Drejtuese

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj mbikëqyrësja e tij e drejtpërdrejtë respektivisht Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit është e obliguar të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për periudhën kur ajo ka qenë mbikëqyrëse e tij nga data 08.11.2022 deri me date 31.11.2022, respektivisht të përfshihet edhe periudha nga data 1 janar 2022 deri me date 29.04.2022 në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Kryetarin e Komunës së Gjilanit, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit Drejtorja e Drejtorisë së Inspektionit në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 për ankuesin Sali Kqiku, si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Anr.323/2023.

Çlirim Zeka



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesin
- Kryetarin të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Gjilanit,
- Arkivit të KPMSHCK.